



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 53 prot.

Kamëz, më 25.6.2025

V E N D I M
Nr. 46 .Datë 25/6 2025
MBI

“MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË BANESAVE SOCIALE NGA KONTRIBUTI I SEKTORIT PRIVAT”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 25.06.2025, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.41 Datë 25.06.2025 në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social në Republikën e Shqipërisë”; Ligjit nr. 9232, datë 13.05.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”; Vendimit nr. 456, datë 16.04.2008 “Për procedurat e vlerësimit dhe të shitjes, si dhe kriteret e përcaktimit të çmimit të shitjes së truallit familjeve, që përfitojnë banesa me kosto të ulët”; VKM-së nr. 132, datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”; VKM-së nr. 325, datë 29.05.2024 “Për përcaktimin e rregullave për kontributin e sektorit privat në krijimin e fondit publik të banesave sociale”; Vendimit nr. 626, datë 15.07.2015 “Për miratimin e normativave të projektimit të banesave”; Urdhrit nr. 1052, datë 02.12.2024 “Për miratimin e mesatares së çmimeve të shitjes së banesave në treg, sipas zonave kadastrale, për njësitë e vetëqeverisjes vendore”, Këshilli Bashkiak Kamëz”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndërtimit të banesave sociale nga kontributi i sektorit privat lidhur me përcaktimet e nenit 19, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, të ndryshuar, në përputhje me objektivat e Programit të Strehimit Social dhe nevojave të evidentuara nga Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale.
2. Banesat sociale do të ndërtohen në pasurinë me nr. 42/26, me Kod Unik 2066004181, në Zonën Kadastrale 2066, Lloji i pasurisë: “Shkëmbore”, me sipërfaqe totale 10000 m², me adresë: Kamëz, në pronësi të pronarit Bashkia Kamëz.
3. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Projekteve dhe Investimeve, Drejtoria e Strehimit dhe Emergjencave Civile, Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale, Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit, Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Prokurimeve Publike si dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

KRYETAR KËSHILLI
HYSEN KOLDASHI